



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

O.SH.P. Klan Kosova
Baton Haxhiu
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2011/118-KPM vs Klan Kosova
Ref: 1210/853/KPM/nr

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2011/118-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër Klan Kosova ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) më datën 18 shkurt 2009, ka vendosur që ofruesit të shërbimeve programore Klan Kosova-Palë Përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore.
2. KPM me 28 gusht 2009, ka nxjerrë Rregulloren KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale. Kjo Rregullore ka hyrë në fuqi më 28 nëntor 2011, me qëllim që të përcaktojë parimet themelore të komunikimit komercial audiovizual, teleshopingun dhe sponsorimet, për transmetimin e tyre në ofruesit e shërbimeve mediale, duke caktuar edhe sasinë e komunikimit komercial audiovizual të transmetuar nga televizionet dhe radiot, duke përfshirë edhe teleshopingun.
3. Po ashtu në të njëjtën kohë Pala Përgjegjëse ka nënshkruar Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Më marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi edhe Rregulloren KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale .
4. KPM ka bërë monitorimin e Pala Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KKPM 2009/04. Me rastin e monitorimit të programit të transmetuar nga ana e Palës Përgjegjëse prej datës 1-5 qershor 2011, KPM ka gjetur se gjatë kësaj periudhe Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veproj në shkelje të Rregullores KKPM 2009/04, përkatësisht nenin 15 paragrafi 3.
5. KPM, bazuar në shkeljen e Rregullores KKPM-2009/04 nga ana e Palës Përgjegjëse me datën 13 qershor 2011, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Përgjegjëse është kërkuar të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

6. KPM edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, serish me datën 15 dhe 16 gusht 2011, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM-2009/04. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 13 qershor 2011, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar brenda një ore për transmetimin e komunikimeve komerciale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.
7. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KKPM-2009/04, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 22 gusht 2011, i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04. KPM me anë të vërejtjes ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren KKPM-2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Pala Përgjegjëse.
8. KPM edhe pas Vërejtjes së dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse ku me datën 23 dhe 24 gusht 2011, ka gjetur se ky subjekt ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04, edhe përkundër vërejtjes së KPM-së për të vepruar në pajtim me Rregulloren KKPM-2009/04. Pala Përgjegjëse serish ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.
9. KPM duke u bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KKPM-2009/04 nga ana e Palës Përgjegjëse me datën 2 shtator 2011, i ka dërguar Urdhër Palës Përgjegjëse, përmes të cilit është urdhëruar që menjëherë të veprohet në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2009/04, sepse në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit për KPM-në, do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra. Ky veprim është i fundit të cilin KPM e ndërmerr për t'i sjell në pajtueshmëri të licencuarit para së rasti të rekomandohet për sanksionim para Komisionit.
10. KPM më qellim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren KKPM-2009/04, serish me datën 7 shtator 2011 ka gjetur së Pala Përgjegjëse edhe përkundër pranimi të Urdhrit si mase e fundit për të vepruar në pajtim me Rregulloren, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04.
11. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren KKPM-2009/04, serish me datën 7 shtator 2012, ka bërë monitorimin dhe ka gjetur së Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimeve për Shkelje, Vërejtjes dhe Urdhrit ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren KKPM-2009/04.

Analiza Ligjore

12. Komisioni bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 15.3 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KKPM-2009/04.

Neni 15.3 i Rregullores KKPM-2009/04 përcakton:

“Komunikimet komerciale audiovizuale në shërbyesit audiovizual komercial privat nuk duhet të kalojnë mesataren ditore prej 12 minutash në orë për çdo orë të kohës së transmetimit gjatë transmetimit ditor”.

13. Komisioni duke u bazuar në raportet e Divizionit të Monitorimit dhe Analizave të Mediave gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 15.3, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim.
14. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes dhe Urdhrit ka vazhduar të veproj në kundërshtim me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.
15. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të Rregullores KKPM-2009/04, prandaj ky Komisionin si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshëm dhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2009/04.
16. Komisioni bazohet në Udhëzimin për Zbatimin e Sanksioneve ndaj të licencuarve i cili përveç tjerave thotë se KPM gjithmonë e ka parasysht natyrën proporcionale të sanksioneve. Sanksionet do të jenë proporcionale me natyrën dhe me seriozitetin e një shkeljeje dhe me shkallen ekonomike të te licencuarit, dhe nuk do të jenë më të rëndë se sa të nevojshme për të parandaluar shkelje tjera dhe për të inkurajuar veprime përmirësuese nga ana e të licencuarit, duke marrë parasysht të gjithë faktorët relevant lehtësues apo rëndues.
17. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale (KKPM-2009/04).

VENDIM

18. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KKPM-2009/04 pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim.
21. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptohet masa sanksionuese Vërejtje për shkeljen e nenit 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.
22. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimi të këtij vendimi vazhdon të veproj në kundërshtim Rregulloren KKPM-2009/04 apo aktet tjera nënligjore të KPM-së, Komisioni do të iniciojë procedura ligjore për ndërmarrjen e masave tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me Nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
23. Komisioni gjithashtu kërkon nga ana e Palës Përgjegjëse që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet të cilat bien ndesh me Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore të KPM-së.


E drejta për Ankesë

24. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.

25. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
26. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërën nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



04 tetor 2012
datë